



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja: Nr. 14

Datë: 12. 03. 2024

Fillimi i takimit: Ora: 16:55

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë

Kryesoi: Kreshnik Radoniqi, Kryesues i KQZ

Anëtarët e KQZ-së prezentë: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiș, Fazli Stollaj

Nga SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ; **Nga ZRCKFSP:** Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP; **Përkthyes:** Argjina Misini; Jehona Cami; **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 13/2024
3. Shqyrtimi dhe miratimit i Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit
4. Shqyrtimi dhe miratimit i Rregullores Zgjedhore Nr.13/2024, Rezultatet Zgjedhore
5. Shqyrtimi dhe miratimi i angazhimit të stafit jo permanente për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat Leosaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahet me datën 21 prill 2024

6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për punën jashtë orarit dhe vëllim të shtuar të punës, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahet me datën 21 prill 2024
7. Të ndryshme !

1. **Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

Mbledhjen e hapi, kryetari Kreshnik Radoniqi. Ai, e paraqiti agjendën e mbledhjes. Ndërsa, tha se “në të ndryshme” është një pikë, dhe një tjetër për buxhetin shtesë...!

Me 9 vota për, u miratua agjenda e mbledhjes. (Me fillimin e mbledhjes, nuk ishin prezentë anëtarët: Alban Krasniqi dhe Sami Kurteshi. Në ndërkohë, ata iu bashkuan takimit.)

2. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 13/2024:**

Kreshnik Radoniqi, pyeti anëtarët se a kanë diçka lidhur me procesverbalin ! Gordana Llaban, kërkoi që të përmirësohet shifra e buxhetit lidhur me procesin e votimit që do të mbahet më “21 prill” e cila, duhet të jetë “233, 204, 0,1 euro”, pra të përmirësohet. Me këtë vërejtje, u miratua me 11 vota për procesverbalin nr. 13/2024.

3. **Shqyrtimi dhe miratimit i Rregullore Zgjedhore Nr.12/2024, Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit:**

Kryetari, pyeti lidhur me miratimin - votimin e kësaj rregullore. **Gordana Llaban**, kërkoi shpjegime rreth përkthimit, dhe tha se kur të publikohen, le të jenë të përkthyer – para se ti aprovojmë...!

Alban Krasniqi, tha se duhet të mirëkuptohemi sepse, jemi duke punuar vazhdimisht sidomos me Arianitin në baza ditore. Disa ndryshime, edhe shërbimi i përkthimit e ka të vështirë me mbërri. Por, është brumi i përkthyer i të gjitha rregulloreve, dhe se ndonjë ndryshim eventual nuk e ndryshon fare bërthamën e tyre. Përndryshe, edhe ne e kemi vështirë nganjëherë me përkufizuar gjithë materialin, tha ai.

Arianit Elshani, tha se nuk ka ndryshim substancial, më shumë janë ndërhyrje teknike, madje bile lekturim, kështu që substanca e tyre është po ajo e ditëve më parë, e që janë të përkthyer...

Me vona unanime (11 vota për, u miratua Rregullorja Zgjedhore Nr.12/2024, Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Zgjedhore Nr.13/2024, Rezultatet Zgjedhore:

U vazhdua me miratimin e rregullores tjetër, nr.13/2024, Rezultatet Zgjedhore. Kryetari Radoniqi pyeti anëtarët nëse kanë diçka për të thënë lidhur me këtë rregullore. Nuk pati ndonjë pyetje, vërejtje, apo ngjashëm.

Me vona unanime (11 vota për, u miratua Rregullorja Zgjedhore Nr.12/2024, Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i angazhimit të stafit jo permanente për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahet me datën 21 prill 2024:

Lidhur me këtë pikë, paraprakisht diskutuan Arianit Elshani, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, kreyshefi Burim Ahmetaj kryesisht lidhur me mënyrën, formën, buxhetin, angazhimin dhe çështjet që lidhen me votimin – standardin e rregullimit të angazhimit të stafit jo permanent. U tha se rregullorja, vlen për si bazë si e rregullon vëllimin e punës shtesë, vëllimin e punës. Por, tash i gjithë institucioni është futur në një rrethanë tjetër, dhe duhen vendime etj. Debati, u fokusua në procedurat që lidhen me stafin jo permanent, punën shtesë të zyrtarëve, si dhe qartësimin e detyrave dhe obligimeve të cilat dalin nga proceset si ky në të cilin tani, jemi ne...

Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për punën jashtë orarit dhe vëllim të shtuar të punës, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahet me datën 21 prill 2024

Në fund të shqyrtimit të gjatë të kësaj pike, me 11 vota për u miratua vendimi i angazhimit të stafit jo permanente për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahet me datën 21 prill 2024.

Kreshnik Radoniqi, tha se është edhe një pikë lidhur me buxhetin shtesë.

Burim Ahmetaj, i informoi anëtarët e KQZ-së se përgjatë ditës, kanë dal edhe dy kërkesa shtesë për buxhet lidhur me votimin e “21 Prillit”. Fjala është për buxhetin për transparencë të punës së KQZ dhe procesit zgjedhor, që nënkupton transmetimin e mbledhjeve të KQZ-së që kap një shifër prej 15, 000 eurove, dhe

krijimin e një “kthine – hapësirë që, do të shfrytëzohet për pauzë, me shërbime kafe dhe qaj. Kjo kosto, është 2000 euro.

Nuk ka incizim më tej...

6. Të ndryshme !

Sami Kurteshi, pyeti lidhur me atë se a ka telefon në dispozicion lidhur me procesin, ku lajmërohen votuesit që paraqesin ankesa, kërkojnë shpjegime, sqarime etj. Them se, duhet vendosur 1 ose 2 numra, meqë edhe është obligim i KQZ-së.

Burim Ahmetaj, tha se është i disponueshëm numri pa pagesë. Kurse, Alban Krasniqi, tha se është mirë të caktohet një zyrtar që përgjigjet në thirrje, dhe që është mirë ai t’i njoh dy gjuhët...

Burim Ahmetaj, tha se kjo është një detyrë shtesë, dhe caktohet dikush...!

Alban Krasniqi, tha se duhet të rregullohet kjo, madje mund të vendoset edhe një numër tjetër, por që kjo të funksionoj, dhe jo të mos përgjigjet askush...

Arianit Elshani, propozoi që të ketën një numër në zyrën e partive, një te shërbimi votues, dhe një numër të përgjithshëm – për informata të përgjithshme...

Në vazhdim, **Burim Ahmetaj** i informoi anëtarët e KQZ-së se IFE-s punon një sërë udhëzimesh vullnetare për kompanit që merren me teknologji informative. Lidhur me këtë, janë cituar kompanitë më të mëdha deri te Morosoft. Këto angazhime, do të prezantohen në Samitin e Demokracisë që mbahet me 19 mars në Seul. Udhëzimet, i kam dërguar. Është kërkuar nga ne të merren në konsideratë udhëzimet, në parim kërkohet dakordim në mënyrë që, dokumenti të prazantohet.

Kreshnik Rdoniqi: Udhëzuesi, është ende draft. Ne, po mendoj se duhemi dërguar një përkrahje...

Alban Krasniqi, tha se do mund të shqyrtohej në KOZ...

Arianit Elshani tha se, janë dy ftesa: një nga IFES dhe tjetra nga Koreja. E para, është një garë në ndryshimin e rolit të KQZ-së, ua dërgoj në imell përmbajtjen se çka është kjo ftesë, kurse tjetra, ka të bëjë për “listim të personave” rreth një programi që zhvillohet on – line, nga 1 maji – deri më 31 maj. Kurse, njoftimi tjetër, është pjesëmarrja në trajnim prej : 11 – 19 qershor. Ua dërgoj informacionet...

